

Tiranë, 17 Maj, 2016

DEKLARATE

BASHKIMI TREGTAR I SHQIPERISE

Fjala Hyrese

Bashkimi i Tregëtarëve të Shqipërisë (BTSH) pasi ka analizuar me kujdes Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 59 datë 30.12.2015 (Shkurt VKB 59), është shumë e shqetësuar për faktin se kjo dispozitë ka rritur nivelin e taksave dhe tarifave lokale me dhjetra dhe qindra herë krahasuar me një Vit më parë apo krahasuar me nivelin e tyre në bashkitë e tjera të vendit. Kriteret që vendos VKB 59 janë jo të drejta, dhe për më tepër, po keq-interpretohen nga Drejtoria e Taksave në Bashkinë e Tiranës. Në vijim po ju prezantojme më të detajuara shqetësimet tona:

1. Tatimet dhe Taksat mund të vendosen vetëm me Ligj - Këshilli Bashkiak nuk mund të vendosë tatime apo taksa që bien në kundërshtim me Ligjin.

Ligji Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar (Neni 2 - Qëllimi i Ligjit) përcakton *"rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre"*. Në bazë të Nenit 8 (Të drejtat e tatimpaguesit), Tatimpaguesi kërkon të drejtat në përputhje me procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe me këtë ligj.

Në bazë të Ligjit për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, tatimpaguesit duhet të informohen në avancë për çdo ndryshim në dispozitat ligjore dhe në procedurat administrative që krijojnë ngarkesë shtesë financiare apo administrative për tatimpaguesin. BTSH, i cili perfaqeson distributorët dhe shitësit me pakice, dhe as kompanitë anëtare të saj, nuk kanë marrë asnjë njoftim dhe nuk i është marrë asnjë mendim për VKB 59, i cili ka rritur me dhjetra dhe qindra herë barrën fiskale të anëtarëve të BTSH, që ushtrojnë aktivitetet nën juridiksionin e Bashkisë Tiranë.

Ligji Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", megjithëse ka ndryshuar për rreth 20 herë në periudhën 2006 - 2016, në nenin 9 të tij ka përcaktuar llojet e taksave vendore ku përfshihen: 1) Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, 2) Taksa mbi pasurinë (tokë, ndërtesa), 3) Taksa e fjetjes në Hotel 4) Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, 5) Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluejtëshme, 6) taksa e tabelës, etj.

Këto kanë qenë në vazhdimësi llojet e taksave vendore, madje Ligji për disa prej tyre (taksën e ndërtesës dhe të tokës bujqësore), që konsiderohen të rëndësishme për qeverisjen vendore, i ka dhënë kompetenca Këshillave Bashkiakë të rrisin deri në 30% ose të ulin deri në 30% nivelin e kësaj takse, apo të lehtësojnë tatimpagues në kushte dhe rrethana të përcaktuara me Ligj. Për lloje të tjera taksash Ligji përcakton direkt nivelin e taksës ose përcakton diapazonin (psh 4-8%) brenda të cilit Këshilli Bashkiak miraton nivelin e taksës. Bashkia nuk mund të

shkelë parimin e vendosjes me Ligj të taksave dhe të kalojë me dhjetra e qindra here ngarkesen totale nga taksat vendore me VKB.

2. Këshilli Bashkiak nuk mund të rrisë ngarkesën fiskale për një tatimpagues të taksave vendore me dhjetra apo qindra herë krahasuar me një vit më parë.

Për shumë anëtarë të BTSH, të cilët nuk kanë patur asnjë ndryshim në biznesin e tyre, vetëm për faktin se psh. Komuna Kashar është pjesë e Bashkisë Tiranë, nga VKB 59, i rritet ngarkesa për taksat vendore 200 - 400 herë krahasuar me një vit më parë. A është kjo e bazuar në Kushtetutën dhe në Ligjet e Republikës së Shqipërisë?

3. Këshilli Bashkiak i Tiranës nuk mund të rrisë ngarkesën për taksa vendore në nivele me dhjetra apo qindra herë më të larta se bashkitë e tjera brenda Republikës së Shqipërisë.

Kjo duket shkelje ose keqpërdorim i parimeve bazë tatimore. A duhet të respektohen parimet e barazisë dhe të konkurrencës së ndershme në vendosjen e taksave vendore? A ka kuptim që një biznes që ndodhet në Kashar (në autostradën Tiranë-Durrës) i krahasuar me një biznes të njejtë të ndodhur qindra metra më tutje (në të njejtën autostradë) por nën juridiksionin e Bashkisë Vorë, ta ketë ngarkesën fiskale për taksat vendore 200 - 400 herë më lartë?

4. Përveç trajtimit jo të drejtë që shkel haptas parimet e barazisë dhe neutralitetit që duhet të ketë sistemi tatimor, ajo që na shqetëson më shumë është keq-interpretimi i Ligjit dhe i vetë VKB 59 nga ana e Drejtorisë së Taksave të Bashkisë së Tiranës. Më konkretisht:

(a) Taksa e përkohëshme për infrastrukturën arsimore (Pika I.f e VKB 59). Duket qartë se dispozita ka diferencuar nivelin e kësaj takse bazuar në madhësinë e biznesit, duke i klasifikuar bizneset në tre kategori:

- Bisnes i Vogël (Taksa 4.000 lekë në vit),
- Bisnes i mesëm (Taksa 15.000 lekë në vit), dhe
- Bisnes VIP (Taksa 37.000 lekë në vit).

Pra duket qartë se taksa e përkohëshme në infrastrukturën arsimore ka marrë parasysh madhësinë e biznesit, duke vendosur një taksë 9,25 herë më të lartë për bizneset VIP krahasuar me biznesin e vogël. Psh. një biznes i vogël shpërndarës me një furgon (distributor) që bën një xhiro vjetore prej 2 milionë në vit, paguan 4.000 lekë taksë arsimit në Vit, ndërsa një biznes VIP (që mund të ketë psh 60 furgona shpërndarës) paguan 37.000 lekë në Vit. Por, sipas interpretimit që bën Drejtoria e Taksave të Bashkisë Tiranë, meqenëse biznesi i dytë ka 60 furgona me NIPT-e sekondare duhet të paguajë $60 \times 37.000 = 2.220.000$ lekë taksë arsimit. Nëse do të merreshin vecmas të 60 furgonët bëjnë një xhiro më të ulët se 2 milionë. Pra bëhet një interpretim në shkelje të vetë VKB 59 që e ka bërë diferencimin për shkak të madhësisë së biznesit.

(b) Taksa e pastrimit dhe e largimit të mbeturinave (pika II.a e VKB 59). Edhe në këtë rast duket qartë se dispozita ka diferencuar nivelin e taksës bazuar në llojin e aktivitetit dhe në madhësinë e tatimpaguesit. Psh. për shitësit me shumicë:

- Bisnes i Vogël xhiro 0-2 milionë lekë (Taksa 3.500 lekë në vit),
- Bisnes i Vogël xhiro 2-8 milionë lekë (Taksa 12.000 lekë në vit),
- Bisnes i mesëm (Taksa 74.000 lekë), dhe
- Bisnes VIP (Taksa 94.000 lekë në vit).

Kriteri i ndjekur ka një llogjikë dhe konsideron natyrën e biznesit dhe madhësinë (xhiron), por përsëri interpretimi që bën Drejtoria e Taksave në Bashki lidhet me numurin e NIPT-eve sekondare (kriter të cilin Ligji dhe VKB nuk e përmendin fare). Pra për të njëjtin shembull të marrë më lart, një bisnes i vogël me xhiro 2 milionë lekë, që bën shpërndarje të mallrave me shumicë, e ka nivelin e taksës së pastrimit 3.500 lekë, ndërsa një bisnes VIP që disponon 60 furgonë me NIPT-e sekondare (me xhiro psh 120 milionë) e ka taksën e arsimit 94.000 lekë në vit, por sipas Drejtorisë së Taksave në Bashki, për rastin e dytë, taksa e pastrimit llogaritet $60 \times 94.000 = 5.640.000$ lekë, sepse ka 60 NIPT-e sekondare për furgonat shpërndarës. Pra vetë Drejtoria e Taksave shkel haptas kriteret e VKB 59 që janë: natyra e biznesit dhe madhësia e biznesit.

Per sa me siper kerkohet, qe ne VKB 59, pika I.f dhe II.a, ne paragrafet perkatese me titull Lehtesira dhe perjashtime, te perjashtohen mjetet e punes, si autovetura, kamionet, etj mjete transporti, te cilet jane te pajisur me NIPT-e sekondare.

5. Taksa e tabelës (pika I.e i VKB 59)

Tabela për qëllime identifikimi, pavarësisht nga sipërfaqja, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve por ku vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë ka qenë në masën 120 lekë/vit, ndërsa duke filluar nga 1 Janari i vitit 2016 kjo taksë është **375-fishuar** duke u përcaktuar në masën 45'000 lekë/m² për sipërfaqet mbi 2m².

Për të sjellë një shembull të thjeshtë dhe konkret, të gjitha fasadat e bareve, marketeve, qendrave të loguara me emrin e kompanisë apo emrin tregtar në brendësinë e tyre, përfshirë këtu dhe mjetet e transportit të cilat regjistrohen si njësi me vete dhe logohen për të identifikuar kompaninë së cilës i përkasin apo për të reklamuar mallrat dhe shërbimet që ofrohen prej tyre, përballesh aktualisht me një shumëfishim të papërballeshëm të Taksës së Tabelës.

Përveç sa më sipër, është dyfishuar taksa e reklamimit elektronik e cila është konkretisht në vlerën prej 90'000 lekë/m² në vit.

Këto tarifa të përcaktuara me Vendim të Këshillit Bashkiak rezultojnë të jenë shumë të larta dhe të papërballeshme për tregtarët e shumicës dhe të pakicës në vendin por, janë shumë herë më të larta dhe të krahasuara me vendet fqinje të rajonit të Ballkanit të cilat, për hir të së vërtetës, kanë standarde ekonomiko-sociale më të larta se në vendin tonë.

Nga një hulumtim që kemi kryer në legjislacionet e vendeve të rajonit për pagesën e Takës së Tabelës, ka rezultuar se kjo taksë vendore e parashikuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi të jetë të paktën **130 herë** më e lartë se vendet fqinje jo-EU dhe **10 (dhjetë) herë** më e lartë në vendet e zhvilluara Europiane nga taksa që paguajnë për të njëjtin qëllim bizneset në vendet e rajonit.

Nëse i referohemi legjislacionit maqedonas, **Taksa e Tabelës** e paguar nga subjektet juridike që ushtrojnë veprimtari tregtare është **EUR 2,5 (dy presje pesë euro)** për metër katror në muaj.

Taksa e Tabelës që aplikohet në Republikën e Maqedonisë bazohet dhe përcaktohet në përputhje me kriterin e **proporcionalitetit** dhe, konkretisht, në respektim të këtij kriteri, Republika e Maqedonisë ka krijuar modele të ndryshme në bazë të së cilave vendoset niveli i kësaj takse që varion nga rajoni në rajon brenda kësaj Republike.

Kjo do të thotë, se Taksa e Tabelës që aplikohet nuk është e njëjtë në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë. Niveli i saj varion nga rajoni në rajon dhe kriteret përcaktues të kësaj takse në nivel rajoni/komune janë në përputhje/proporcion me faktorët socialo-ekonomik dhe zhvillimore të vet rajonit.

Në një tablo krahasuese më të gjerë, dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj dhe raportin e pagesës së kësaj takse krahasuar me vende të tjera, pjesë e Bashkimit Europian si: Italia, e cilësuar si një nga vendet më të taksuara në Europë.

Taksa e Tabelës për qytetet me 400.000-1.000.000 banorë është **77 euro/m²** dhe sipërfaqe e matshme për përlogaritjen e taksës konsiderohet vetëm pjesa e tabelës së shkruar, që zakonisht është rreth 40% (dizetë përçind) e sipërfaqes. Për gjithë sipërfaqen e tabelës, përfshirë dhe pjesën e pashkruar të saj, taksa do rezultojë të jetë rreth **32 euro/m²**.

Pra, në Shqipëri, me të ardhura për frymë rreth 1/5 (një e pesta) e Italisë, Taksa e Tabelës është rreth **10 (dhjetë) herë më e lartë** (45`000 lekë të barzvllefshme me rreth 320 euro/m² në vendin tonë, kundrejt 32 euro/m² në Itali).

Per sa me siper kerkohe, qe ne VKB 59, pika I.e, Kategoria 1) a) pika a.1, taksa per Tabelen per qellime identifikimi mbi 2 m² te pershkallezohet.

5. **Taksa mbi ndertesën (pika I.a1 e VKB 59):**

Ne kategorine II, perkateisht per Ndertesat per tregti dhe sherbime (BM+VIP) kerkohe qe te behet klasifikim diferencues per llojet e pasurive te paluajtshme, ne njesi, apartamente dhe garazhe, pasi sipas ketij vendimi tarifimi i tyre eshte i njejte dhe ne nivel maksimal prej 440 leke m².

Si konkluzion mendojmë se taksat e mësipërme dhe sidomos mënyrat e interpretimit nga Drejtoria e Taksave në Bashkinë e Tiranës është e pabazuar në Ligj, dhe duhet të sistemohen sa më parë.

VKB 59 gjithashtu përmban shumë dispozita të tjera dhe procedura që mund dhe duhet të përmirësohen, në mënyrë që dispozitat e miratuara të jenë të drejta, të sigurojnë shpërndarje të drejtë të ngarkesës fiskale dhe procedurat zbatuese të jenë të qarta dhe të thjeshta si për bizneset ashtu edhe për drejtorinë e taksave vendore.

BTSH shpreh gadishmërinë për të bashkëpunuar me të gjithë aktoret dhe Drejtorinë e Taksave në Bashki dhe me Këshilltarët Bashkiakë për hartimin e këtyre dispozitave.

Faleminderit,

Shoqata “Bashkimi Tregtar i Shqipërisë”